



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 28

Prishtinë, më 24.1.2022, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla, N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Adnan Rustemi, Driton Selmanaj, Ljubinko Karaxhiq, Artan Abrashi, Hydajet Hyseni- Kaloshi, Dimal Basha, Hajdar Beqa, Blerta Deliu- Kodra Besnik Tahiri dhe Erxhan Galushi.

Mungoi: Doarsa Kica- Xhelili.

Mbledhjen e kryesoi: Adnan Rustemi, kryetar i Komisionit.

Pjesëmarrës të tjerë: Agon Ziberi, GLPS; Alban Nasufi, asistent i kryetarit; Taulant Hoxha, KCSP; Selman Sokolaj, studiues; Esad Ejupi, Yll Buleshkaj dhe Afrim Atashi, AKK; Shefki Kastrati, NDI; Albert Krasniqi, D+; Agnesa Haxhiu, KDI; Elena Elshani dhe Qendresa Beka, praktikante.

Nga stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Fatbardha Boletini dhe Mirlinda Kolgeci.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 26.11.2021, 8.12.2021, 13.12.2021 dhe 17.12.2021;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-106 për ratifikimin e Marrëveshjes për Ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut;

4. Shqyrtimi në parim i Projekt-Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës;
5. Shqyrtimi i Raportit të performancës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2022;
6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar;
7. Të ndryshme;

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime, me propozimin e deputetit Driton Selmanaj, që pika e pestë e rendit të ditës të zhvendoset si pikë e tretë të rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 26.11.2021, 8.12.2021, 13.12.2021 dhe 17.12.2021;

Kryetari, konstatoi se procesverbalet e mbajtura nga mbledhjet e datës 26.11.2021, 8.12.2021, 13.12.2021 dhe 17.12.2021 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të performancës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2022;

Kryetari, paraqiti për shqyrtim raportin e performancës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2022 duke thënë se Ligji nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura në nenin 43, ka përcaktuar obligimin e komisioneve funksionale që në bazë të një procesi dialogu të miratojë Planin Vjetor të Performancës për Agjencitë e caktuara të Pavarura. Po ashtu, tha se Agjencisë në mungesë të drejtorit i është pamundësuar procedimi dhe prezantimi i Planin Vjetor. Më tej ftoi drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsionit të prezantojë Planin Vjetor të Performancës për vitin 2022.

Yll Buleshkaj, theksoi se plani vjetor i performancës do të kthehet në plan të punës duke u specifikuar me indikatorë për secilin aktivitetet të propozuar. Buleshkaj sqaroi se në mungesë të drejtorit, Agjencisë i janë trashëguar disa borxhe nga viti i kaluar që përfshinë 1/3 e buxhetit të Agjencisë. Në vitin 2022 Agjencia synon që me aprovimin e legjislacionit të ri, të harmonizojë legjislacionin e ri me aktet nënligjore.

Buleshkaj në vazhdim potencoi se janë në fazën finale të testimit dhe funksionalizimit të sistemit online të deklarimit si dhe menaxhimit të rasteve të Agjencisë që ndikon në menaxhimin më të saktë dhe të shpejtë të rasteve si dhe eliminon kontaktin fizik të panevojshëm.

Kryetari, tha se e rëndësishë së veçantë është planifikimi i Agjencisë për implementimin e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe Ligjit për deklarimin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve publikë, të cilat implikojnë mandatin e agjencisë dhe vëllimin e punës.

Yll Buleshkaj, shtoi se ndër detyrat shtesë të Agjencisë është edhe shqyrtimi i legjislativës për mundësi të elementeve korruptive në të. Agjencia me ndihmën e UNDP-së ka zhvilluar një metodologji të punës që duhet finalizuar.

Driton Selmanaj, potencoi se ka vërejtje në raport tek objektivat dhe aktivitetet për vitin 2022. Ai theksoi se aty janë listuar disa aktivitete të Agjencisë që nuk janë objektiva, por detyra të përshkruara të punës së përditshme të Agjencisë. Në këtë kontekst, tha se ka mirëkuptim në këtë fazë për raportin vjetor si praktikë e re, për shkak të marrjes së mandatit para një kohe të shkurtër dhe për shkak të ndryshimeve legjislative në proces, por jo dhe në të ardhmen.

Dimal Basha, u pajtua me deputetin Selmanaj dhe propozoi krijimin e një aplikacioni të Agjencisë, sidomos në shërbim të sinjalizuesve të pranimit të rasteve lidhur me korrupsion. Këto informacione do të vinin në formë anonime dhe do lehtësonin punën e Agjencisë si dhe ndikojnë në rritjen e besimit.

Artan Abrashi, tha se janë ndeshur me një konkurrencë të madhe gjatë përzgjedhjes së Drejtorit të Agjencisë kundër Korrupsionit, prandaj dhe pritshmëritë për z. Buleshkaj në krye të Agjencisë janë të mëdha.

Hydajet Hyseni – Kaloshi, pasi i uroi suksese z. Buleshkaj në punën në Agjenci, si fushë e rëndësishme dhe pengesë kryesore në procesin e integritetit evropian, tha që i ka bërë përshtypje jo të mirë që shumica e kandidatëve për drejtor kanë pasur tendencë për të thjeshtuar dhe lehtësuar aktivitetin e Agjencisë dhe beson që në plan do të bashkëpunojnë dhe se do të kenë qasje përplotësuese që t’ia dalin edhe në këtë pengesë të Kosovës.

Hajdar Beqa, theksoi se në plan nuk ka ndonjë risi përveç sistemit online si domosdoshmëri e kohës. Tek detyrat dhe objektivat, përmendet funksionalizimi i platformës për deklarimin online të pasurisë, a ekziston dhe a është në funksion kjo platformë? Beqa pyeti se si funksionon kontrolli paraprak dhe kontrolli i plotë 20% i listës së përgjithshme. Po ashtu, tha se në të njëjtën kohë për të bërë rishikimin e zyrtarëve kontaktues dhe kërkesat për caktimin e tyre nëse mungojnë dhe trajnimin e zyrtarëve kontaktues dhe njoftimi për ndryshimin në sistemin e deklarimit të pasurisë për institucionet tjera, a ka Agjencia staf të mjaftueshëm, që mund të mbulojë gamën e punës së Agjencisë kundër korrupsionit.

Yll Buleshkaj, tha se pajtohet që formati i planit është i përgjithësuar dhe se kryesisht flitet për aktivitete. Lidhur me pyetjet për platformën online, tha se është gjithëpërfshirëse dhe përfshinë

aplikacionin për raportim të rasteve si dhe deklarimin dhe menaxhimin e rasteve. Gjithashtu shtoi se kanë mangësi teknike si në aspektin e stafit edhe të serverëve në proces të realizimit, që si rezultat i tenderit do të funksionalizohen brenda vitit. Ndër të tjera sqaroi se personat kontaktues janë nga institucionet tjera, jo të Agjencisë dhe vlerësimi i tyre do të bëhet në mënyrë të vazhdueshme si dhe do të trajnohen kudo që është e nevojshme.

Buleshkaj potencoi se me aprovimin e ligjit të ri do të bëhet vlerësimi nëse Agjencia ka nevojë për riorganizim me qëllim të përmirësimit të performacës së institucioneve. Ka shumë vende të lira në njësitë të caktuara, pasi ka pasur pezullim të detyrave si rezultat i legjislacionit dhe nga pjesëtarë të stafit diplomatik. Ai njoftoi se shumë shpejt do të dilet me plan të zvogëlimit të rasteve që barten vit pas viti që momentalisht janë deri në 100 raste.

Sa i përket qëllimit të Agjencisë, qëllimi kryesor është rritja e komunikimit me aktorë të jashtëm për çka është hartuar dhe strategjia që ndikon në informimin e mirëfilltë të publikut dhe duke kthyer përgjigje më të shpejta në kërkesa.

Kryetari, tha se duhet filluar planifikimet e kapaciteteve dhe akteve nënligjore pasi që do të ketë zgjerim të mandatit dhe të vëllimit të punës me Projektligjin e parandalimit të Korrupsionit si dhe Projektligjin për deklarimin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve publikë.

Meqë nuk pati diskutime tjera, kryetari konstatoi se me 7 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komisioni nxori këtë:

V e n d i m

Miratohet Plani i Performancës për vitin 2022 i Agjencinë kundër Korrupsionit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-106 për ratifikimin e Marrëveshjes për Ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut;

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.08/L-106 për ratifikimin e Marrëveshjes për Ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Projektligji ka 3 nene mbi ratifikimin e marrëveshjes që ka për qëllim përmirësimin e mëtejme të bashkëpunimit të ndërsjellë në çështjet civile në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut si dhe ofrimin e mbrojtjes më efektive të të drejtave dhe interesave të dy shteteve dhe shtetasve të tyre. Marrëveshja zbatohet parimisht për të gjitha çështjet civile, përfshirë procedurat lidhur me statusin, marrëdhëniet familjare, të punës, trashëgiminë, pronësinë dhe marrëdhëniet tregtare të personave fizikë dhe juridikë. Po ashtu, parashihet njohja dhe ekzekutimi i ndërsjellë i vendimeve gjyqësore dhe të arbitrazhit si dhe çfarëdo forme tjetër e ndihmës juridike që nuk është në kundërshtim me të drejtën e palës së kërkuar. Në fund kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Hajdar Beqa, tha se e ka analizuar mirë memorandumun shpjegues dhe ka ardhur në përfundimin se Projektligji nuk paraqet kosto buxhetore për Republikën e Kosovës si dhe do ndikojë në lehtësimin e bashkëpunimit juridik civil në mes të dy shteteve.

Meqë nuk pati diskutime tjera, kryetari konstatoi se me 8 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet Projektligji nr.08/L-106 për ratifikimin e Marrëveshjes për Ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut

5. Shqyrtimi në parim i Projekt-Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës;

Kryetari, paraqiti për shqyrtim në parim Projekt-Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe tha se Komisioni për Legjislacion ka themeluar Grupin e punës, i cili ka punuar së bashku me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet tjera në përpjekje për të hartuar draft-rregullore e re të punës së Kuvendit të Kosovës, si kontinuitet i punës së grupeve të mëparshme punuese. Komisioni për Legjislacion ka nisur punën dhe ka themeluar grupin punues, ndërkohë që ia ka drejtuar Kryesisë së Kuvendit draftin përfundimtar të grupit punues, draft-rregullore që është kthyer në Komision për të futur në procedurë të shqyrtimit dhe miratimit në parim për procedim në Kuvend të Kosovës. Rregullorja e re synon që praktikat e mira të Kuvendit të Kosovës ti formalizojë dhe institucionalizojë, me zgjidhje konkrete në aspekte të ndryshme të funksionalitetit në probleme të hasura gjatë 10 vjetëve të fundit.

Besnik Tahiri, theksoi se Rregullorja e punës së Kuvendit vjen pas 10 vjetësh, në një moment shumë të rëndësishëm. Tahiri falënderoi Komisionin si dhe Institutin Demokratik Amerikan dhe të gjitha organizatat joqeveritare të përfshira në proces, po ashtu, falënderoi edhe stafin e Komisionit për Legjislacion për punën e bërë gjatë kësaj periudhe. Si rezultat i debateve të argumentuara dhe qëndrimeve të kundërta doli një dokument mjaft i mirë që duhet votuar nga të gjithë. Për fund Tahiri ngriti dy çështje të rëndësishme të veçantë, sanksionimin e deputetëve dhe krijimin e kushteve të punës për deputetë.

Kryetari, tha se do të mund të kontribuojnë në mes të dy leximeve, në bazë të vërejtjeve dhe rekomandimeve të marra. Meqenëse rregullorja miratohet me 2/3 të deputetëve, ka konsensus në çdo dispozitë dhe do të përpiqen që me të njëjtin konsensus të vazhdohet deri në fund.

Hydajet Hyseni – Kaloshi, theksoi se për realizim sa më të mirë do duhej dhe një herë të rishikohet draft-rregullorja nen për nen nga Komisioni. Sa i përket çështjes së dytë, theksoi se nuk duhet anashkaluar Ligj për deputetët, që është kontestuar vetëm në dy pika që do mund të korrigjohet lehtësisht dhe do të duhej të procedohej bashkë me Rregulloren apo njëra pas tjetrës, për shkak të ndërlidhjes që kanë.

Blertha Deliu – Kodra, tha se në këtë fazë të Rregullores, ka dilema nëse mund të inkorporohet Ligji për deputetët. Ajo shtoi se lidhur me draft-rregulloren Grupi i Punës, është munduar të gjej zgjidhje për vakumet që kanë përcjellë punën e Kuvendit në 10 vjetët e fundit. Pasi uroi që të vazhdohet me konsensusin e njëjtë, Deliu - Kodra përgëzoi anëtarët për punën e bërë.

Driton Selmanaj, theksoi që punën më të madhe e kanë kryer grupet e punës të mëparshme, deputetë dhe përfaqësues të OJQ-ve të involvuar dhe e vetmja gjë që i ka mbetur deputetëve është shprehja e vullnetit politik. Nga çështjet e adresuara, Selmanaj veçoi si vlera të shtuara reflektimin e aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese, rregullimin e çështjes së kuorumit në votim, rregullimi i çështjes së shmangies të procedurave në seanca parlamentare, trajtimi i vetos së Presidentes nëse kthehet, Konferencën e kryetarëve, dallimi mes dëgjimeve publike dhe seancave dëgjimore. Disa organizata të shoqërisë civile që nuk kanë qenë të përfshira në proces të konsultimit, çështjet me rëndësi mund t'i adresojnë në mes leximit të parë dhe të dytë në mënyrë që t'i adresojnë dilema apo kërkesat që mund ti kenë në funksion të asaj që të bëhet sa më i zbatueshëm ky dokument.

Hajdar Beqa, theksoi se dhe në legjislaturën e vitit 2017, kur ka qenë kryesues i Grupit të Punë për Rregulloren e punës së Kuvendit, ka pasur një unitet të mirë mes deputetëve deri në lexim të dytë.

Meqë nuk pati diskutime tjera, kryetari konstatoi se me 9 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet, në parim, Projekt-Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 08/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar;

Kryetari, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente për projektligjin nr. 08/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar dhe njoftoi se grupi i punës i themeluar nga Komisioni për Legjislacion ka përgatitur Raportin me amendamente për Projektligjin nr.08/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar.

Kryetari konstatoi se bëhet fjalë vetëm për një amendament teknik dhe fjalën ia dha kryesuesit të Grupit Punues, Dimal Basha të prezantojë raportin para Komisionit.

Dimal Basha, njoftoi se është mbajtur një takim i grupit punues dhe meqenëse Projektligji nuk është voluminoz, ka pasur vetëm ndryshim-plotësime të ardhura nga Zyra për Standardizim. Komente ka pasur dhe zyra e BE-së, mirëpo pa propozime shtesë.

Driton Selmanaj, theksoi se Komisioni duhet t'i shkruaj Qeverisë për draftimin e projektligjeve, pasi që është hera e dytë që detyrohen të bëjnë amendamente të tilla teknike, në këtë rast vetëm për të larguar kllapat.

Kryetari, tha se do gjej mekanizëm për të përcjellë mesazhin dhe shton se është lajm i mirë që Grupi i punës nuk ka gjetur vërejtje tjera.

Meqë nuk pati diskutime tjera, kryetari konstatoi se me 8 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komisioni miratoi raportin me rekomandime dhe vendosi që, Kuvendit dhe komisioneve kryesore t'ua paraqesë këtë:

R a p o r t

Për Projektligjin nr. 08/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar

Amendamenti 1

Në nenin 2, 4,5 dhe 8 të Projektligjit, të fshihen kllapat që teksti të jetë në përputhje me standardet e hartimit të legjislacionit.

7. Të ndryshme.

Në këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:05.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Adnan Rrustemi,
Kryetari i Komisionit,
